

LEDIA DUSHKU

**NË PËRPPJEKJE PËR TË QETËSUAR JUGUN E SHQIPËRISË:
LËVIZJET DIPLOMATIKE TË MARSIT 1914**

Më 7 mars 1914, ish kapiteni i kavalerisë gjermane Vilhelm Vidi (Wilhelm fon Wid), caktuar nga Fuqitë e Mëdha si princ i Shqipërisë, mbërriti në Durrës. Sakaq, vështirësia kryesore që ai hasi ishte pamundësia e ushtrimit të sovranitetit në të gjithë territorin e shtetit shqiptar. “Lëvizja Vorioepirote” e aktivizuar në territoret jugore, për të kundërshtuar vendimin e Fuqive të Mëdha për bashkimin e krahinës së Korçës dhe të Gjirokastrës me shtetin shqiptar, ishte pengesa kryesore e shtrirjes së attributeve qeverisëse në Shqipërinë e Jugut. Më 2 mars 1914, aty ishte shpallur “autonomia e Epirit të Veriut” dhe ishte krijuar një qeveri me në krye Jorgo Zografosin (Georgios Zografos), ish guvernator i përgjithshëm i administratës greke në territoret e pushtuara të Shqipërisë së Jugut. Situata bëhej edhe më e vështirë nga prania e trupave greke, të cilat nuk ishin tërhequr nga territoret jugore, megjithëse Luftërat Ballkanike kishin përfunduar.

Në momentet e para, princi i Shqipërisë preferoi ta shtrinte autoritetin e tij në Shqipërinë e Jugut me rrugë diplomatike, me anën e bisedimeve të drejtpërdrejta me vorioepirotët. Ai e trajtoi “Lëvizjen Vorioepirote” si çështje të brendshme, duke krijuar përshtypje se “nuk ka dëshirë të përdorë ndihmën e Komisionit Ndërkombëtar” për zgjidhjen e saj¹. Qëndrimi i Vidit ndaj Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit

¹ *Ministere des Affaires Etrangères, Archives Diplomatiques* (më tej: *AMAE*) në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Fondi 149, fl. 414, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për ministrin e Jashtëm të Francës, Dumerg, Korfuz: mars 1914.

Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit u krijua nga Fuqitë e Mëdha në Konferencën e Londrës. Sipas neneve 4, 5 dhe 6 të vendimit përfundimtar për Shqipërinë, të datës 19 korrik 1913 “Kontrolli i administratës civile dhe financiare të shtetit shqiptar i besohet një Komisioni Ndërkombëtar ...”, “kompetencat e të cilit do të zgjatnin 10 vjet dhe mund të përtëriheshin në rast nevojë”, “Komisioni do të ngarkohej për hartimin e një projekti të hollësishëm për organizimin e të gjitha degëve të administratës së Shqipërisë...”. Shih: Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet*

konsiderohej prej anëtarëve të tij, jo dashamirës². Që në fjalimin e tij të parë, ditën e mbërritjes në Durrës, ai deklaroi qartë “vullnetin për t’u angazhuar drejtpërsëdrejti në organizimin e shtetit, ndërsa vendi do t’i kishte shprehësit e interesave të tij, falë veprimtarisë së një Senati të zgjedhur, një pjesë nga Princi dhe pjesa tjetër nga populli”³. Deklarata nuk u prit mirë nga përfaqësuesit e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, të cilët nuk e shihnin pozitivisht “qëllimin e Lartmadhërisë së tij, për t’i tërhequr Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit sa më shumë nga kompetencat administrative që ai ushtron”⁴.

Bisedimet Tomson-Karapanos

Më 9 mars 1914, Vidi emëroi kolonelin holandez, Tomson (Lodewijk Willem Johan Karel Thomson) në detyrën e Komisarit të Përgjithshëm të Jashtëzakonshëm për distriktet e Korçës dhe të Gjirokastrës. Ish deputet në parlamentin e Holandës, Tomsoni ishte nënkryetar i misionit holandez, për organizimin e xhandarmërisë së shtetit shqiptar. Misioni ishte krijuar në vitin 1913 me vendim të Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe kryesohej nga gjenerali tjetër holandez De Ver (De Weer). Si komandant i Xhandarmërisë Shqiptare për Jugun pretendohet se Tomsoni e njihte mirë gjendjen në

ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik), Vëll. II (1912-1918), Tiranë: “8 Nëntori”, 1987, f. 278-279.

² Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi 1506 (Koleksion dokumentesh nga arkivat ruse), viti 1914, dos. 4-16, fl. 24-25, Raport i komandantit të Kanonierës ruse “Tereç” drejtuar Ministrisë së Marinës ruse, 8 maj 1914.

Në lidhje me Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, Vilhelm Vidi shprehej se ai “...që në përgjithësi një pjellë e pafat. Në të vërtetë ai përfaqësonte 6 Fuqitë e Mëdha, por nuk kishte asnjë pushtet ekzekutiv. Në masë të vogël edhe tek ai u manifestuan të gjitha kundërshtimet, që ekzistonin midis Trepalëshit dhe Antantës, në çështjet e mëdha politike..... Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit formonte një lloj qeverie më vete, i cili jo vetëm që u jepte rëndësi të madhe përbushjes së plotë të kompetencave të veta, ende të pacaktuara mirë, por edhe përzihej në çështjet e qeverisë shqiptare, p.sh kërkonte t’u jepte direktiva oficerëve holandezë. Tek të gjithë anëtarët e tij ishte bërë sëmundje, të bëje politikë dhe të shpërndaje këshilla.....”. Shih: *AIH*, A-IV-66, *Kujtimet e Vidit*, fl. 9, 20.

³ Ferdinando Salleo, *Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri*, Tiranë: “Shtëpia e Librit dhe Komunikimit”, 2001, f. 72.

⁴ *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, Editori i Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe, dt: 7 mars 1914.

terren. Koloneli holandez mendonte se “e vetmja rrugë për të rifituar Epirin ishte diplomacia”⁵, sepse “ne [shqiptarët] gjendeshim kundër diçkaje më të fortë se forcat tona të vogla dhe të pajisura keq”⁶. Në dekretin e emërimit, vihej në pah dëshira e shtetit shqiptar për të ushtruar të drejtën e sovranitetit, të njohur nga Fuqitë e Mëdha, dhe për t’u “shpënë banorëve të atyre viseve, regjimin e barazisë dhe të drejta themelore për çdo qytetar”⁷. Dekreti i jepte Tomsonit fuqi të plotë për të siguruar rendin dhe funksionimin e mirë të qeverisjes në Shqipërinë e Jugut, menjëherë pas largimit të trupave greke nga distriktet e Korçës dhe të Gjirokastrës. Me anën e emërimit të Tomsonit, Princi arriti të mënjanonte Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për çështjet që i takonin Shqipërisë së Jugut⁸.

Qeveria greke, e cila në vazhdimësi i kishte përshtatur kërkesat e saj në lidhje me Shqipërinë në varësi të qëndrimit të Fuqive të Mëdha, në momentin e mbërritjes së Vidit, synonte që në Shqipërinë e Jugut të arrinte: në akordimin e një lloji autonomie administrative; në përfshirjen e elementëve lokalë në xhandarmëri dhe së fundmi që garancitë administrative të ishin aq oportune sa të eliminonin ose së paku të kufizonin çdo lakmi eventuale për ndërhyrje nga ndonjë Fuqi e Madhe e interesuar.

Duke mos shpresuar në një zgjidhje pozitive me autoritetet shqiptare, Athina zyrtare synonte plotësimin e kërkesave të mësipërme nga Fuqitë e Mëdha, në kuadrin e përgjigjes që këto të fundit duhej t’i jepnin notës greke, të 21 shkurtit të vitit 1914⁹. Në fillim të marsit ende

⁵ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë: “Toena”, 2009, f. 136.

⁶ D. Heaton Armstrong, *Shqipëri-1914. Gjashtë muaj Mbretëri*. (Kujtimet e sekretarit të Princ Vidit), Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Tiranë: 2001, f. 42.

⁷ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSSt.A.P.A.A.*), në *AIH*, Vj. 24-42-4210, Dekreti i princ Vidit për emërimin e Tomsonit në detyrën e Komisarit të Përgjithshëm të Jashtëzakonshëm për distriktet e Korçës dhe të Gjirokastrës, Durrës: 9 mars 1914.

⁸ *Archives du Ministère des Affaires Etrangères, France* (më tej: *AMAE*) në *AIH*, F. 149, fl. 190-196, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për ministrin e Jashtëm të Francës, Dumerg, Korfuz: 14 mars 1914.

⁹ Nota e 21 shkurtit ishte përgjigja që qeveria greke i ktheu notës së Fuqive të Mëdha, të datës 13 shkurt 1914. Me anën e saj Athina i dha fund zyrtarisht kokëfortësisë diplomatike, për të mbajtur të pushtuara territoret e Shqipërisë së Jugut. Në notë, ajo deklaroi gatishmërinë greke për t’u pajtuar me vendimin e Fuqive të Mëdha për Shqipërinë dhe pranoi të tërhiqte trupat nga territori i shtetit shqiptar në përputhje me afatet e caktuara nga Fuqitë e Mëdha, pa bërë asnjë rezistencë. Por qeveria greke kërkoi

pa mbërritur Princi në Durrës, qeveria greke u kërkoi Fuqive t'i kthenin një përgjigje të shpejtë, veçanërisht mbi atë pjesë të notës, ku ajo kërkonte të drejta dhe garanci për vorioepirotët¹⁰. Greqia dëshiroi që Britania e Madhe të luante rolin e iniciatorit në lidhje me kërkesat saj. Por qeveria britanike e konsideroi të pavend një rol të tillë. Në telegramin që ministri i Jashtëm Eduard Grei (Eduard Grey), i dërgoi ministrit grek në Londër, njoftoi se qeveria e tij “është në pritje të komunikimit nga Austro-Hungaria dhe Italia, para se të bëjë ndonjë propozim”¹¹.

Deklarata britanike e bindi qeverinë greke se rruga për të zgjidhur sipas interesave të saj “çështjen e Vorio Epirit”, kalonte nga Austro-Hungaria dhe Italia. Për këtë arsye, Athina në vazhdimësi i kushtoi kujdes të posaçëm, kontakteve me Vjenën dhe Romën. Nga ana e tyre, Fuqitë e Adriatikut, më 8 mars 1914, i nisën një notë të përbashkët Ministrisë së Jashtme greke¹². Teknikisht nota ishte përgjigja që ato po i kthenin notës greke të 21 shkurtit. Dy Fuqitë nuk pranorin rektifikim të kufirit në zonën e Korçës sepse ai ishte në kundërshtim me vendimet e Londrës dhe ekskluzivisht në dëm të Shqipërisë. Ishte i mundur vetëm një rektifikim kufitar në zonat e tjera jugore. Por, edhe ai ishte i kushtëzuar. Rregullimin e mundshëm “dy kabinetet do ta marrin në

rektifikim kufijsh në luginën e Gjirokastrës (Aneksi A) dhe këmbënguli në çështjen e “garancive të mjaftueshme dhe efikase”, për të gjithë popullsinë ortodokse në Shqipëri, të cilën në vazhdimësi e konsideronte greke. Garancitë duhej të përfshinin të drejtën e pronës së trashëgueshme, gjuhës, besimit dhe organizimit kishtar. Zona e Himarës, zinte një vend specifik në notë. Fakti që ajo kishte gëzuar gjithnjë një autonomi të gjerë në kohën e Perandorisë, duhej të merrej parasysh prej Fuqive të Mëdha në momentin kur të vendosnin organizimin administrativ të Shqipërisë. Nota ishte kështu një hap drejt autonomisë administrative për territoret jugore shqiptare, duke lënë të hapur çështjen e bashkimit të tyre me Greqinë, në të ardhmen e afërme. Për më shumë shih: Ledia Dushku, “Përpyekjet e politikës greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut: nga diplomacia në veprime të armatosura (shtator 1913- shkurt 1914)”, në *Studime Historike*, Nr. 1-2/2010, f. 69-70.

¹⁰ *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 122-123, Telegram i ministrit të Jashtëm britanik, Grei për ministrin britanik në Athinë, Londër: 2 mars 1914; *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 13, Njoftim i ministrit francez në Rusi për Ministrinë e Jashtme franceze, 3 mars 1914. Mbi Notën që Ministria e Jashtme e Mbretërisë së Rosisë ka marrë nga homologia e saj greke.

¹¹ *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 122-123, Telegram i ministrit të Jashtëm të Britanisë së Madhe për ministrin e tij në Athinë, Londër: 2 mars 1914.

¹² *Po aty*, fl. 128, Notë e Austro-Hungarisë dhe Italisë për qeverinë greke, Athinë: 8 mars 1914.

shqyrtim sapo trupat greke do të kenë zbrazur territorin, që i është dhënë Shqipërisë”. Si Vjena ashtu edhe Roma i bënë me dije qeverisë greke se ato mbështesnin garantimin e lirisë së plotë të besimit dhe përdorimit të greqishtes, krahas shqipes, për popullsinë greke në Shqipëri. Ato ishin të gatshme të merrnin në konsideratë dhe përkrahnin pranë Princit edhe kërkesën greke për pranimin në xhandarmërinë shqiptare, të elementëve të aftë epirotë.

Nota entuziazmoi dhe njëkohësisht shtoi oreksin e qeverisë greke. Më tej, ajo kërkoi që Fuqitë të ndërhyjnë edhe në çështjet e administrimit të brendshëm të Shqipërisë. Por, Austro-Hungaria nuk e shihte të pëlqyeshme që Fuqitë të merreshin hollësisht me këtë çështje, të cilën e konsideronte si kompetencë të qeverisë shqiptare¹³. Ajo këshilloi homologen e saj greke që t’i drejtohej vetë Princit sepse çështja e pozitës së popullsisë greke në Shqipëri nuk varej nga Fuqitë e Mëdha dhe çdo ndërhyrje nga ana e tyre do të thoshte marrje nëpër këmbë e sovranitetit të shtetit shqiptar¹⁴.

Qeveria greke kishte kështu një arsye më shumë për vendosur marrëdhënie të drejtpërdrejta me Vidin. Me anën e tyre, ajo mund të influenconte pranë autoriteteve të larta shqiptare, jo vetëm në çështjet e administrimit të brendshëm, por edhe për të njohur e legjitimuar autoritetin e diskutueshëm të qeverisë së Vorioepirit. Zhvillimi i bisedimeve mes autoriteteve shqiptare dhe atyre vorioepirote ishte hapi i parë për njohjen e saj. Zgjidhja e “çështjes së Epirit të Veriut” sipas dëshirës së popullsisë së atjeshme, e cila për Athina zyrtare përfaqësohej nga qeveria e Zografosit, konsiderohej si pengesa e vetme për marrëdhënie miqësore me Shqipërinë¹⁵.

Zbatuesi i kësaj politike, ishte një nga funksionarët më të mirë të shtetit grek, ish-prefekti i Korfuzit, Varatasi (Konstandinos Baratas), tashmë i dërguar në Shqipëri, si delegat special i qeverisë greke. Varatasi shquhej për natyrën e tij bashkëpunuese me shqiptarët. Ai ishte mendjehollë, fjalë pak, administrator me përvojë, por mbartës i ideve nacionaliste ekstreme. Delegati grek kishte për detyrë të binte në kontakt

¹³ *HHSSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 24-41-4179, Raport nga Vjena për ministrin e Austro-Hungarisë në Durrës, Vjenë: 11 mars 1914.

¹⁴ A. Puto, *Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1978, f. 385.

¹⁵ *HHSSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 24-2-222, Raport i ministrit të Austro-Hungarisë në Paris për Ministrinë e Jashtme, Paris: 19 maj 1914.

me Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për të vendosur me të detajet në lidhje me çështjen e kufirit jugor të Shqipërisë dhe për të rregulluar vështirësitë, që mund të dilnin nga tërheqja e ushtrisë greke prej territoreve shqiptare. Pavarësisht karakterit të emërimit, Varatasi u kujdes pak për të negociuar me Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, ndërsa punoi fort për të vendosur marrëdhënie mirëbesimi të drejtpërdrejta mes Greqisë dhe Princit¹⁶. Ai u tregua përbuzës ndaj punës së Komisionit dhe shfaqti prirje të dobësonte rolin e tij¹⁷. Në kushtet kur Fuqitë nuk shfaqnin qëndrime të përbashkëta në lidhje me administrimin e Shqipërisë së Jugut, sigurisht që ishte më e lehtë të merreshe vesh me një njeri, sesa me gjashtë anëtarë të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, prapa të cilëve në marrjen e vendimeve ishin qeveritë përkatëse.

Varatasi depërtoi shumë shpejt tek Princi, falë edhe terrenit të përshtatshëm që oborri rumun kishte krijuar nëpërmjet këshillave që i kishte dhënë Vidit, për të bashkëpunuar me Greqinë. Ai “ndihmoi” Princin të bindej përfundimisht për të hyrë në marrëveshje të drejtpërdrejta me qeverinë e Zografosit¹⁸. Prej konsullit francez në Korfuz, pretendohet se emërimi i Tomsonit në detyrën e Komisarit të Jashtëzakonshëm për Jugun, ishte bërë me nxitjen e delegatit grek. Nëpërmjet këtij emërimi, Greqia synonte që dëshirat e saj të gjenin vend, jo vetëm tek autoritetet shqiptare, por edhe të mbizotëronin ndaj dëshirave të delegatëve të Fuqive të Mëdha në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit¹⁹. Marrëdhëniet mes Tomsonit e Varatasit relatoheshin të afërta dhe Komisari i sapoemëruar nën ndikimin grek. Kapiteni holandez frymëzohej “pak si shumë nga dëshirat e popullsisë epirote dhe nuk shqetësohet aq sa duhej ndaj dëshirave të qeverisë shqiptare, për mbajtjen e integritetit të vendit”²⁰. Ai deklaronte se ishte i gatshëm të bënte lëshime të gjera për popullsinë e Shqipërisë së Jugut, përderisa besonte

¹⁶ AMAE në AIH, F. 149, fl. 190, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për ministrin e Jashtëm të Francës, Dumerg, Korfuz: 14 mars 1914.

¹⁷ *Po aty*, F. 151, fl. 1031-1037, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për Ministrinë e Jashtëm, Korfuz: 30 prill 1914.

¹⁸ Timo Dilo, “Çështja e “Epirit të Veriut” nga pikëpamja diplomatike” në *Bota e Re*, Nr. 3, 1945, f. 15.

¹⁹ AMAE në AIH, F. 149, fl. 190, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për ministrin e Jashtëm të Francës, Dumerg, Korfuz: 14 mars 1914.

²⁰ *Po aty*, F. 150, fl. 611-614, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për ministrin e Jashtëm të Francës, Dumerg, Korfuz: 11 prill 1914.

në sinqeritetin e qeverisë greke, në lidhje me evakuimin e ushtrisë nga territoret e shtetit shqiptar²¹.

Fill pas emërimit, më 10 mars të vitit 1914, komisar i Jashtëzakonshëm u nis nga Durrësi në drejtim të Korfuzit “për të marrë informacione për gjendjen në Jug dhe për të hyrë në bisedime me Zografosin”²². Sapo mbërriti në Ishull, Tomsoni kontaktoi me Varatasin, i cili pranoi rolin e ndërmjetësit duke i telegrafuar Athinës, në emër të tij. Kryeministri grek, Venizellos (Eleftherios Venizelos) u përgjigj shpejt dhe siguroi të tëra lehtësirat për zhvillimin e bisedimeve²³. Ai autorizoi delegatin special grek “të lehtësonte këtë kontakt [mes Tomsonit dhe Zografosit] me shpresën se negociata do të mund të qetësonte shpirtrat dhe do të shpinte në rezultate të mira”²⁴. Sakaq, Varatasi kontaktoi me Zografosin duke “e ftuar” atë të hynte në bisedime me Komisar in e Jashtëzakonshëm.

Takimi u realizua më 15 mars 1914. Zografosi nuk mori pjesë në bisedime. Ai i kishte dhënë mandat përfaqësimi, ministrit të Jashtëm së të ashtuquajturës qeveri të Epirit Autonom, nipit të tij, Aleksandër Karapanosit (Aleksandros Karapanos). Takimi i Tomson-it me Karapanosin u zhvillua në prani të Varatasit. Pasi paraqiti një ekspozitë mbi gjendjen në Jug, Karapanosi kërkoi nga qeveria shqiptare “pavarësi mbi bazë autonomine”, çka nënkuptonte një autonomi tejet të zgjeruar analoge me atë të Hungarisë, në Mbretërinë Dualiste Austro-Hungareze; dy guvernatorë zviceranë ose holandezë, një për Korçën e një për Gjirokastrën; formimin e një Këshilli nën secilin guvernator; xhandarmëri lokale; liri të plota për shkollat greke; liri në përdorimin e fesë; përjashtimin e krahinës së Himarës nga sistemi i taksave; etj.

Në raportin dërguar qeverisë shqiptare, Tomsoni njoftoi se e kishte kundërshtuar në mënyrë të prerë kërkesën për autonomi, sepse “nuk mund të pranoja parime të tilla, të cilat shkatërrojnë themelet e shtetit

²¹ *HHSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 24-14-1438, Raport i Konsullit të Përgjithshëm të Austro-Hungarisë në Vlorë për Ministrinë e Jashtme, Vlorë: 18 mars 1914. Mbi misionin e Tomsonit.

²² *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), Viti 1914, Dosja Nr. 30, fl. 1. Raport i Tomsonit për qeverinë shqiptare, Gjirokastrë: 16 mars 1914

²³ *Po aty*.

²⁴ *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 172-174, Raport i ministrit të Francës në Paris për ministrin e Jashtëm të Francës, Dumerg, Paris: 13 mars 1914.

tonë të ri”²⁵. Në takim, ai kishte deklaruar dëshirën e tij për të arritur “një marrëveshje liberale me një afat prej pesëdhjetë vjetësh” mes palëve, e cila sipas tij do të shmangte kasaphanën që mund të shkaktohej nga urrejtja mes shtetasve shqiptarë.

Duke pretenduar se kishte fuqi të plota, Komisar i Jashtëzakonshëm propozoi “përfaqësim krahinor proporcional për Shqipërinë e Jugut”. Krahinat jugore duhet të ndaheshin në dy distrikte, atë të Korçës dhe të Gjirokastrës. Në krye të çdo distrikti do të emërohej një guvernator. Nëse Zografoja pranonte propozimet, Tomsoni merrte përsipër ta propozonte atë në postin e guvernatorit të Gjirokastrës. Organizimi i distrikteve do të bëhej nga Asambleja Krahinore, që do të kishte seli të lëvizshme, herë në Gjirokastrë e herë në Korçë. Asambleja Krahinore, në marrëveshje me Komisar i Përgjithshëm të Jashtëzakonshëm, i cili ishte përfaqësuesi suprem i shtetit shqiptar dhe drejtues i punimeve të saj, duhej të studionte gjithçka që ishte e dobishme për administrimin e Shqipërisë së Jugut²⁶. Xhandarmëria shqiptare duhej të ishte unike, por detashmentet e saj, që do të përdroreshin në Shqipërinë e Jugut, do të kishin në përbërje të tyre sa të ishte e mundur xhandarë me origjinë nga krahinat jugore. Njësitë e xhandarmërisë në Jug do të përbëheshin nga të krishterë dhe myslimanë, numri i të cilëve do të ishte në përpjesëtim me numrin e popullsisë. Propozimet, jepnin të drejta të barabarta për të gjitha besimet fetare dhe liri arsimore, të shoqëruara me detyrimin për të mësuar gjuhën shqipe. Për të penguar propagandën, do të vepronin Këshillat Lokalë, të cilët duhet të mbikqyrnin funksionimin e shkollave.

Në stadin fillestar në të cilin ndodhej shteti shqiptar, propozimet e Tomsonit nuk ishin të favorshme nga pikëpamja e forcimit të unitetit shtetëror. Ato krijonin një provincë të privilegjuar, aq sa diplomatët e Fuqive të Mëdha në Shqipëri, e konsideronin “me të vërtetë të pavarur”²⁷. Në parim, Tomsoni pranonte autonominë e krahinave jugore, duke njohur

²⁵ AMPJ, Viti 1914, Dosja Nr. 30, fl. 1. Raport i Tomsonit për qeverinë shqiptare, Gjirokastrë: 16 mars 1914.

²⁶ Po aty.

²⁷ AMAE në AIH, F. 149, fl. 251, Raport i delegatit të Francës në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për ministrin e Punëve të Jashtme të Francës, Dumerg, Vlorë: 19 mars 1914; HHS.A.P.A.A në AIH, Vj. 24-14-1442, Raport i konsullit austro-hungarez në Vlorë për ministrin e Jashtëm, Bertold, Vlorë: 20 mars 1914.

vetëm një varësi formale të tyre nga shteti shqiptar²⁸. Forcimi i unitetit të shtetit shqiptar ishte i vështirë të arrihej edhe sepse Komisari i Jashtëzakonshëm u rekomandonte autoriteteve vendimmarrëse shqiptare, që “nëse lëshimet e propozuara për krahinat e Jugut pranohen, ato duhet t’u jepen edhe krahinave të tjera të tij [shtetit shqiptar]”²⁹. Adaptimi i një Asambleje Krahinore, atributet e së cilës ishin padyshim identike me ato të Asamblesë Kombëtare, të parashikuar nga Statuti Organik i Shqipërisë, përbënte një lloj vetëqeverisjeje lokale, një decentralizim administrativ për të ardhur keq, madje të rrezikshme, duke marrë parasysh qëllimet finale të drejtuesve vorioepirotë për shpëtim nga shteti shqiptar dhe bashkim me Greqinë. Edhe liria e arsimit përbënte një privilegj po ashtu të rrezikshëm për shtetin shqiptar. Në kushtet kur Shqipëria kishte pak mundësi të pajiste shkollat me personelin mësimor të nevojshëm, ato do të vazhdonin të ishin nën ndikimin e propagandës greke. Pavarësisht, krijimit të Këshillave Lokalë, propaganda nuk kishte gjasa që të frenohej, sepse nuk mund të shmangej dominimi i Këshillave nga elementë nën ndikimin grek³⁰.

Propozimet që Tomsoni i bëri Karapanosit me gjasë nuk kanë qenë të konsultuara me Princin dhe qeverinë shqiptare, e cila u formua më 14 mars 1914, kohë kur ai gjendej në Korfuz. Sipas diplomatit austro-hungarez, Kral (August Kral), ata u vunë në dijeni sapo Komisari mbërriti në Gjirokastër, pasi kishte lënë Korfuzin³¹. Më 23 mars 1914, qeveria shqiptare u mblodh për të diskutuar në lidhje me propozimet e Tomsonit. Komisari i Jashtëzakonshëm u gjend nën kundërshtimin e ashpër e të vendosur të qeveritarëve shqiptarë. Për shkak të temperamentit të rrëmbyer, ai nuk mundi ta ruante gjakftohtësinë, duke ndezur edhe më shumë debatin. Ndërhyrja e matur e kryeministrit, Turhan pashë Përmetit, arriti të qetësonte situatën. Tomsoni u akuzua se kishte “tejkalluar kuadrin e mandatit të akorduar me dekret mbretëror” dhe

²⁸ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: “Kristalina-KH”, 2007, f. 65.

²⁹ *AMPJ*, viti 1914, dos. nr. 30, fl. 1. Raport i Tomsonit për qeverinë shqiptare, Gjirokastër: 16 mars 1914.

³⁰ *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 251, Raport i delegatit të Francës në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për ministrin e Jashtëm të Francës, Dumerg, Vlorë: 19 mars 1914.

³¹ *HHS.t.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 24-14-1438, Telegram i Konsullit të Përgjithshëm të Austro-Hungarisë, Kral për Ministrinë e Jashtme, Durrës: 18 mars 1914.

lëshimet që ai u kishte propozuar epirotëve u hodhën poshtë³². Po në të njëjtën ditë, kryeministri shqiptar i kërkoi Vidit “ta shkarkojë nga funksionet e Komisarit, kolonelin Tomson, në mënyrë që qeveria mbretërore të ruajë krejt independencën për ta trajtuar çështjen në konformitet me interesat e vendit”³³. Princi e pranoi propozimin. Tomsoni u shkarkua dhe bisedimet me Zografon u ndërpre.

I menjëhershëm ishte edhe reagimi i qeverisë greke. Duke iu referuar historianit grek Vasil Kondis (Basil Kondis), qeveria “me t’u njoftuar për propozimet e Tomsonit, arriti në përfundimin se Zografosi duhej t’i pranonte ato tërësisht”³⁴. Por, në telegramin që kryekonsulli austro-hungarez i Korfuzit i dërgoi ministrit të Jashtëm, më 25 mars 1914, pretendohet se qeveria greke i kishte konsideruar të diskutueshme propozimet e Tomsonit³⁵. Në pritjen javore, organizuar me ministrat e Fuqive të Mëdha në Athinë, ministri i Jashtëm grek, Streit (Georgios Streit), shtoi se propozimet e palës shqiptare “njohin vetëm një pjesë të privilegjeve. Ato nuk mjaftojnë për të paqësuar banorët”³⁶. Ai kërkoi shpejtimin e përgjigjes së Fuqive të Mëdha ndaj notës greke të shkurtit, si një mënyrë e mundshme për të qetësuar popullsinë vorioepirote. Nga ky komunikim kupton se qeveria greke ishte duke i përdorur bisedimet, me qëllimin e vetëm për t’i shtyrë Fuqitë e Mëdha, t’i kthenin përgjigje pozitive, kërkesave të saj të shkurtit 1914.

Në deklaratimet e saj të vazhdueshme, qeveria greke mbështeti vendosjen e një administrate lokale në Shqipërinë e Jugut, të ndarë në distrikte. Drejtimi i tyre duhej t’i besohej guvernatorit, të zgjedhur sipas shumicës së popullsisë, duke shtuar një autoritet ortodoks, atje ku guvernatori ishte mysliman dhe një autoritet mysliman, atje ku ai ishte ortodoks. Xhandarmëria duhej të ishte lokale dhe të përdorej vetëm në distriktet prej nga ishte rekrutuar. Një sistem i tillë nuk i shërbente bashkimit dhe harmonizimit të shtetasve shqiptarë, por shtonte dallimet

³² *Po aty*, Vj. 24-6-672, Raport i të dërguarit të Austro-Hungarisë në Durrës për Ministrinë e Jashtëme, Durrës: 29 mars 1914.

³³ *AIH*, A-IV-330, fl. 108-109.

³⁴ Vasilis Kondis, *Greqia dhe Shqipëria në shek. XX*, Selanik: Paratiristis, 1997, f. 69.

³⁵ *HHSSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 24-14-1446, Telegram kryekonsullit të Korfuzit për Ministrinë e Jashtëme, Korfuz: 25 mars 1914.

³⁶ C. Σκενδέρης, *Ο Βορειοηπειρωτικός αγών 1914*, Athens: 1930 (Shfrytëzuar materiali në: *AIH*. A-IV-212, Kostandin Skënderis, *Lufta për Epirin e Veriut në vitin 1914*, Athinë, 1930, f. 76).

midis tyre. Si i tillë, ai mbarte pasoja të rrezikshme për unitetin brenda shtetit shqiptar. Ajo çka synonte të realizonte qeveria greke kishte të bënte me kufizimin e sovranitetit dhe të drejtës së vetëvendosjes së Shqipërisë. Shqetësim për të, mendoj të ketë qenë fakti se propozimet e Tomsonit nuk i garantonin Greqisë të drejtën e interesimit aktiv për ortodoksët e Shqipërisë, dëshirë e deklaruar tashmë prej saj. Nisur nga ky interes, ajo i kërkoi Austro-Hungarisë dhe Italisë të merrnin përsipër angazhime karshi një të treti [nënkupto Greqinë], në lidhje me organizimin e brendshëm të shtetit shqiptar³⁷. Pranimi i kësaj kërkesë i jepte Greqisë në dorë argumentin për t'u përzier në punët e brendshme të Shqipërisë³⁸. Ajo kufizonte sovranitetin dhe të drejtën e vetëvendosjes së shtetit shqiptar për çështje të administrimit të brendshëm.

Bisedimet e detyruara shqiptaro-greke

Ndërkohë që bisedimet me vorioepirotët ishin ndërprerë dhe gjendja në terren ishte bërë edhe më shqetësuese, pranë qeverisë shqiptare ishte rritur presioni nga ndërkombëtarët për të rifilluar bisedimet dhe për të bërë lëshime. Tek rifillimi i bisedimeve dhe zbrazja e menjëhershme e territoreve nga ushtria greke, Fuqitë e Mëdha shikonin perspektivën për vendosjen e paqes në Shqipërinë e Jugut³⁹. Ministri i Jashtëm italian deklaronte i vendosur se “do të jetë e vështirë të shtypet Lëvizja Vorioepirote, në qoftë se nuk do të ndihmohej qeveria greke dhe Zografosi, për të pasur një sukses, qoftë ky edhe sa për dukje, duke i siguruar ndonjë lëshim elementit grek në Shqipërinë e Jugut”⁴⁰. E rëndësishme për të ishte që lëshimet të mos ishin në favor të privilegjeve tokësore, të cilat do t'i shërbenin qeverisë greke si pretekst për ndërhyrje në Shqipëri.

Për ta eliminuar “Lëvizjen Vorioepirote” dhe për të vendosur paqen në Shqipërinë e Jugut, në qeverinë shqiptare dalloheshin dy rryma. Nga njëra anë kryeministri dhe ministrat e moderuar, të cilët mbështesnin zgjidhjen diplomatike me anë negociatash; nga ana tjetër, ministri i

³⁷ *HHS.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 24-21-2199, Letër e ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë për ministrin në Romë, Vjenë: 18 mars 1914.

³⁸ *Po aty*.

³⁹ *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 133, Telegram i ministrit të Britanisë së Madhe në Vjenë për ministrin e Jashtëm, Grei, Vjenë: 4 prill 1914.

⁴⁰ *HHS.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 24-7-758, Raport i ministrit austriak në Romë për Ministrinë e Jashtme, Romë: 12 mars 1914.

Brendshëm e i Luftës, Esat Toptani së bashku me mbështetësit e tij, partizanë të një aksioni ushtarak⁴¹.

Në mbështetje të pikëpamjes së tij, ministri Toptani kishte propozuar rekrutimin e 30.000 vullnetarëve, të cilët në të ardhmen e afërme duhej të ishin bërthama e ushtrie shqiptare, krijimi i së cilës do të siguronte një administrim të qetë të Shqipërisë⁴². Propozimi nuk u prit me optimizëm prej Vidit, i cili i trembej ambicieve pa kufi të Esat Toptanit⁴³. Për natyrën e brishtë që Princi kishte, rruga diplomatike ishte e preferuar për zgjidhjen e çështjeve delikate. Ai mbështeti propozimin e Tomsonit për krijimin e një xhandarmërie shqiptare, e cila krahasuar me ushtrinë kishte më pak mundësi të çonte në konflikte të armatosura me shtetet fqinje.

Edhe qeveria greke insistoi në vazhdimin e mëtejshëm të bisedimeve mes qeverisë shqiptare dhe të ashtuquajturës qeveri të Vorio Epirit. Në kushtet kur Fuqitë e Mëdha nuk i kishin kthyer ende përgjigje për notën e shkurtit, qeveria greke dëshiroi ta përdorte vazhdimësinë e bisedimeve, si argument për të përfituar një shtyrje të afatit të tërheqjes të ushtrisë së saj, përtej 31 marsit. Më 27 mars 1914, ajo i dërgoi një notë Fuqive të Mëdha, ku kërkoi pikërisht këtë gjë: shtyrjen e afatit të tërheqjes⁴⁴. Nota linte të kuptohej se qeveria greke priste përgjigjen e Fuqive të Mëdha për notën e shkurtit dhe zhvillimin e bisedimeve mes qeverisë shqiptare dhe Zografosit, për t'i dhënë ushtrisë së saj urdhrin përfundimtar për tërheqje. Në vigjilje të 31 marsit, datës së skadimit të

⁴¹ *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 299-301, Raport i delegatit të Francës në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për ministrin e Jashtëm, Dumerg, Vlorë: 24 mars 1914; *AMAE* në *AIH*, F. 150, fl. 484, Raport i konsullit francez në Korfuz për Ministrinë e Jashtme, Korfuz: 4 prill 1914; *HSt.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 24-6-691, Raport i ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë për të ngarkuarin në Durrës, Vjenë: 3 prill 1914.

⁴² Esat Toptani e konsideronte krijimin e ushtrisë shqiptare, si një ndër detyrat më urgjente dhe më të rëndësishme të shtetit shqiptar. Mendimet e tij në lidhje me krijimin dhe organizimin e saj, ai ia kishte bërë të ditura kazerit gjerman, në Nojvid, ku kishte shkuar në krye të delegacionit shqiptar shqiptar, për t'i dhënë kurorën, Vilhelm Vidit. Shih: Karl Buhberger, "Vjetët e mia në Shqipëri" në *Studime Historike*, Nr. 4, 1972, f. 166.

⁴³ *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 414, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz: mars 1914.

⁴⁴ *HSt.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 24-6-669, Telegram i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë për ministrin në Romë, Vjenë: 28 mars 1914. Mbi lajmin telegrafik të qeverisë greke.

afatit të tërheqjes së ushtrisë, qeveria greke urdhëroi trupat e saj të grumbulloheshin e të qëndronin gati, në pritje të një urdhri të dytë⁴⁵.

Për të treguar besnikërinë ndaj vendimeve të Fuqive të Mëdha, qeveria greke “e konsideroi detyrë të këshillonte vazhdimisht epirotët për të mos bërë rezistencë”⁴⁶. Pavarësisht se u deklarua e huaj në “Lëvizjen e Vorio Epirit”, ajo nuk qe e prirur ta pengonte atë. Athina zyrtare u përpoq ta shfrytëzonte Lëvizjen për t’i njohur territoreve jugore të shtetit shqiptar, karakterin e pretenduar grek. Më 22 mars 1914, pas kthimit nga Athina, ku rikonfirmoi detyrën e delegatit special, Varatasi zhvilloi një takim me disa prej anëtarëve të së ashtuquajturës qeveri të Epirit Autonom⁴⁷. Ai u kërkoi atyre të vazhdonin më tej bisedimet me shqiptarët. Por, zhvillimi i bisedimeve nuk dukej se merreshin seriozisht prej tyre. Vazhdimisht Venizellosi e kishte këshilluar Zografosin të ishte i arsyeshëm dhe të bisedonte me shqiptarët, por këshillat nuk kishin vlerë sepse ai kishte humbur çdo lloj kontrolli⁴⁸.

Qeveria e Zografosit manifestoi dëshirë për t’i çuar punët deri në ekstrem. Shpallja në mes të marsit 1914 e mobilizimit të përgjithshëm për të gjithë burrat nga 18 deri në 40 vjeç⁴⁹, shkonte në mbështetje të përdorimit të forcës. Duke marrë në konsideratë fondet që priteshin të vinin nga Greqia dhe praninë e trupave të armatosura greke në terren, ishte e qartë se ajo ishte në gjendje të krijonte ngatërresa të papëlqyeshme për shtetin e ri shqiptar⁵⁰. Politika ekstreme e Zografosit u përkrah veçanërisht nga opozita greke, e cila shpejtoi ta ndihmonte me të gjitha mjetet⁵¹. Ajo u përpoq ta shfrytëzonte ecurinë negative të “çështjes epirote”, si kundërpeshë ndaj politikës qeveritare të Venizellosit.

⁴⁵ *Po aty*, Vj. 24-42-4211, Telegram i ministrit të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë: 30 mars 1914. Mbi lajmin telegrafik të qeverisë greke.

⁴⁶ V. Kondis, *Greqia dhe Shqipëria...*, f. 79.

⁴⁷ *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 414, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz: mars 1914; *HHSSt.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 24-14-1446, Telegram kryekonsullit të Korfuzit për Ministrinë e Jashtme, Korfuz: 25 mars 1914.

⁴⁸ *HHSSt.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 24-9-967, Telegram i ministrit të Austro-Hungarisë në Greqi për Ministrinë e Jashtme, Athinë: 25 mars 1914.

⁴⁹ *Po aty*, Vj. 24-41-4162. Shpallje e Ministrisë së Luftës së qeverisë së Epirit për mobilizimin e përgjithshëm, Gjirokastër: mars 1914.

⁵⁰ *Po aty*, Vj. 24-14-1440, Raport i Legatës së Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë: 21 mars 1914.

⁵¹ *AIH*, A-IV-213, fl. 74.

Shkarkimi i Tomsonit i dha fund dyshimeve rreth vazhdimet të punës tij. Qeveria shqiptare nuk e njohu autoritetin e qeverisë së Zografosit dhe nuk pranoi të zhvillonte bisedime me të. Për ta eliminuar paqësisht lëvizjen, një rrugë e mundshme u konsiderua ajo e bisedimeve të drejtpërdrejta me delegatin grek, Varatasin. Duke qenë se qeveria shqiptare e konsideronte Greqinë, frymëzuese të “epirotëve”, pritej që kjo rrugë të jepte rezultate. Bisedimet me Varatasin iu sugjeruan qeverisë shqiptare edhe nga Vjena. Nëse ato nuk do të jepnin rezultat, Princi dhe qeveria shqiptare ishin të detyruar t’i jepnin fund lëvizjes në Jug nëpërmjet përdorimit të forcës⁵².

Ditët e fundit të marsit, qeveritarë të lartë shqiptarë, zhvilluan bisedime të fshehta me delegatin special grek, i cili kishte mbërritur në Durrës, më 26 mars 1914. Me porosi të kryeministrit shqiptar, Turhan Pashës, njëri nga ministrat e kabinetit, emri i të cilit nuk del nga dokumentacioni i konsultuar, qëndroi në kontakte me delegatin grek⁵³. Kontaktet relatohen të kenë qenë private, edhe për faktin se qeveria greke vazhdonte të mos e njihte qeverinë shqiptare. Mes tyre u shkëmbyen mendime në lidhje me gjendjen e popullsisë në Jug të Shqipërisë. Varatasi i kërkoi qeverisë shqiptare të hynte në bisedime të drejtpërdrejta me autoritetet epirote. Ndonëse deklaroi se nuk e konsideronte veten shprehës të të drejtave të epirotëve, ai i dorëzoi ministrit shqiptar, propozimet e Zografosit, të cilat me ironi i konsideroi “si të tepruara”. “Qeveria e Përkohshme e Epirit” i qëndronte fort kërkesës për autonomi të zgjeruar. Ajo kërkonte krijimin e një Kuvendi Provincial, me të drejtën e përfaqësimit në Kuvendin Kombëtar Shqiptar. Një komisar i lartë i posaçëm, në emër të Princ Vidit, duhej të ushtronte pushtetin ekzekutiv. Të gjitha privilegjet kishtarë, shkollorë dhe të bashkësisë, të gëzuara në periudhën osmane, duhej të mbeteshin të paprekura. Xhandarmëria duhej t’i nënshtrohej vetëm autoriteteve të “Epirit”. Ajo duhej të përbëhej vetëm nga banorë të Shqipërisë së Jugut, madje në shërbim duhej të lejoheshin edhe oficerë e nënoficerë grekë, kryesisht me prejardhje nga “Epiri”. Krahina e Himarës duhej të gëzonte një administratë të veçantë. Statusi i Epirit duhej të miratohej nga një Kongres Epirot⁵⁴.

⁵² *HHS.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 24-7-728, Raport i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Austro-Hungarisë për ministrin e Jashtëm, Bertold, Vjenë: 6 mars 1914

⁵³ *AQSH*, Fondi 486, viti 1914, dos. 571, fl. 64-69, Raport nga delegati rus në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Jashtme, Vlorë: 26 mars 1914

⁵⁴ *Po aty*.

Takimin e dytë, Varatasi e zhvilloi me kryeministrin shqiptar, më 30 mars 1914⁵⁵. I dërguari i qeverisë greke i dorëzoi Turhan Përmetit kërkesat e Zografosit, të përmbledhura në materialin e titulluar “Dokument i që ka të bëjë me gjendjen kushtetuese në Shqipëri të krahinave të bashkuara të Gjirokastrës dhe të Korçës, që formojnë Epirin e Veriut”. Ishte i njëjti material, të cilin Varatasi ia kishte dorëzuar ministrit shqiptar, disa ditë më parë. Dokumenti në fjalë ishte programi mbi të cilin ai mbështetej për të diskutuar me qeverinë shqiptare, duke shpresuar të influenconte tek ajo, për të zhvilluar bisedime me Zografosin dhe autoritetin qeverisës që ai pretendonte se përfaqësonte. Qeveria e Athinës nuk merrte përsipër të zhvillonte bisedime me qeverinë shqiptare në emër të tyre. Me gjithë karakterin e papërcaktuar të këtyre bisedimeve, ngushtësisht personale, delegati grek kishte dalë nga takimi me shpresë, se me qeverinë shqiptare mund të realizohej një marrëveshje mbi disa nga pikat e vëna si kusht nga Zografosi, që kishin të bënin me shkollat, besimin dhe xhandarmërinë⁵⁶.

Nga ana e saj, qeveria shqiptare kishte filluar të kuptonte se “Lëvizjes Vorioepirote”, ishte e vështirë t’i jepej fund, pa ndonjë lëshim⁵⁷. Por, bisedimet mes palëve dhe për më tepër lëshimet, do ta vinin atë nën presionin e rretheve nacionaliste shqiptare⁵⁸. Në dallim nga ndërkombëtarët, këto rrethe nuk i mbështesnin bisedimet dhe lëshimet për popullsinë në Jug. Delegati rus në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, Petriajev (Petriaeff) mendonte se qeveria shqiptare nuk shihte rrugëdalje tjetër veçse t’i jepte gjithë kësaj çështjeje një karakter ndërkombëtar⁵⁹. Po sipas tij, kryeministri shqiptar, Turhan pashë Përmeti dhe mbështetësit e tij në qeveri preferonin ta linin çështjen në duart e

⁵⁵ *HHS.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 24-6-686, Telegram i ministrit të Austro-Hungarisë në Durrës për Ministrinë e Jashtme, Durrës: 31 mars 1914; *AMAE* në *AIH*, F. 150, fl. 473-476, Raport i delegatit francez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Jashtme, Vlorë: 4 prill 1914

⁵⁶ *AMAE* në *AIH*, F. 150, fl. 473-476, Raport i delegatit francez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Jashtme, Vlorë: 4 prill 1914.

⁵⁷ *AQSH*, Fondi 486 (Koleksion i fondeve personale, 1913-1944), viti 1914, dos. 571, fl. 64-69, Raport nga delegati rus në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Jashtme, Vlorë: 26 mars 1914.

⁵⁸ *AMAE* në *AIH*, F. 150, fl. 484, Raport i konsullit francez në Korfuz për Ministrinë e Jashtme, Korfuz: 4 prill 1914.

⁵⁹ *AQSH*, Fondi 486, viti 1914, dos. 571, fl. 64-69, Raport i delegatit rus në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Jashtme, Vlorë: 26 mars 1914.

Evropës, por pa lënduar sedrën e Princit dhe pa bërë shumë të pakënaqur Esat Pashën, partizan i përdorimit të forcës.

Pas takimit me delegatin grek, kryetari i qeverisë shqiptare i deklaroi në mënyrë të prerë dhe të vendosur, anëtarit francez dhe rus në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit se: “qeveria shqiptare, kurrë nuk do të hyjë në bisedime me qeverinë epirote. Ajo është e vendosur që t’ia lërë Fuqive të Mëdha kujdesin për të rregulluar këtë çështje. Fuqitë e Mëdha i kanë bërë Shqipërisë shumë shërbime, për të cilat ne do t’u jemi gjithmonë mirënjohës. Por ato nuk duhet të presin nga ana jonë t’i bëjmë shërbimin që t’i çlirojmë nga çështja e Epirit. Ajo u përket atyre dhe është detyra e tyre që ta rregullojnë ashtu siç ato do ta kuptojnë”⁶⁰. Nëse koncesionet bëheshin nga Komisioni i Kontrollit në emër të Fuqive të Mëdha, Princi dhe qeveria shqiptare nuk angazhoheshin drejtpërsëdrejti. Kjo rrugë pretendohet se i impononte heshtje nacionalistëve shqiptarë, të cilët “do të përulëshin para dispozitave të marra nga Evropa”⁶¹. Edhe ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë i kërkoi të ngarkuarit të tij në Durrës, t’i sugjeronte kryeministrin shqiptar që krahas ndjekjes së linjës së bisedimeve të drejtpërdrejta, t’i kërkonte Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit rolin e ndërmjetësuesit dhe t’i jepte atij autorizim për pajtim⁶². Rolin ndërmjetës të Komisionit e mbështeste edhe ministri i Jashtëm italian. Po shkohej kështu drejt delegimit të kompetencave nga qeveria shqiptare tek Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit.

Bisedimet e diplomatike të marsit të vitit 1914 rikonfirmuan edhe një herë vështirësitë që shqiptarët dhe grekët kishin në gjetjen e një zgjidhjeje kompromisi. Propozimet e skajshme dhe të papranueshme nga njëra anë dhe fryma e mosbesimit dhe e dyshimit reciprok nga ana tjetër, i shoqëruan dukshëm diskutimet. Ishin po këto veçori, të cilat përcaktuan edhe përfundimin pa sukses të tyre. Bisedimet e marsit nuk ndikuan në përmirësimin e situatës në Shqipërinë e Jugut. Në muajt në vijim ajo u bë më e nderë dhe gjithnjë e më shumë jashtë çdo kontrolli qeveritar.

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ *AMAE* në *AIH*, F. 150, fl. 484-487, Raport i konsullit francez në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz: 4 prill 1914.

⁶² *HHSSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 24-6-691, Raport i ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë për të ngarkuarin në Durrës, Vjenë: 3 prill 1914.

*S u m m a r y*TRYING TO CONCILIATE THE SOUTH: THE DIPLOMATIC
MOVEMENTS OF MARCH 1914

The principal difficulty that Wilhelm of Wied came across, as soon as he arrived in Albania, was the impossibility of pursuing his sovereignty through the entire territory of the State of Albania. The “Movement of Northern Epirus”, active in the southern territories, was the most important barrier for the spreading of the governing attributes in Southern Albania. In the beginning, the Prince of Albania chose to spread his authority through the South, using diplomatic means, with discussions on the ground. The Dutch Colonel Thomson, named by a royal enactment with the duty of Specific Commissar for the South, developed in Corfu a series of discussions with the Minister of Foreign Affairs of the government of Northern Epirus, A. Karapanos. On the other hand, members of the Albanian Cabinet got into unofficial discussions with Mr. Varatas, the special delegate of the Greek Government in Albania.

The diplomatic debates of March 1914 reconfirmed the difficulties met by Greeks and Albanians on compromising a solution. These debates were obviously accompanied all along by extreme and unacceptable propositions by the ones and an atmosphere of disbelief and reciprocal doubts by the others. These specificities were what designed the debates’ unsuccessful conclusion. The debates of March did not contribute on the improvement of the situation in Southern Albania. During the months that followed, this situation grew tauter and out of any governmental control.

